




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## Nj o f t i m P u b l i k

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05nr.350/02-170736/24 dt.27.12.2024, në emër të aplikuesve: Agim dhe Uran Dibrani, Enliat Shala, Flamur Breznica, Mehmet Veseli, Muhamet Neziri dhe Investitor “Nord”sh.p.k., përmes së cilës kërkohet të caktohen kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e Kompleksit të ndërtesave individuale banimore / shtëpive familjare, **dy Tipe:** në vargje dhe shtëpi dyshe, me etazhitet P+1 & B+P+1 të në kuadër të bllokut urban “E-05”, të tërësisë urbane “E”, të “Plani Rregullues i Hollësishëm Sofalia 2016-2024”, PZHU-se, konkretisht parcelave kadastrale nr. 662-1, 662-2,661-0 ZK Sofali.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **21.02.2025** deri më **07.03.2025**, në E-mail adresën: [urbanizmpriштine@rks-gov.net](mailto:urbanizmpriштine@rks-gov.net)

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	“Mal i klasit 2”,
b. Vija rregulluese	Sipas projektit konceptual
c. Vija ndërtimore	3.00m’ – 5.00m’ nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ 6.00m’ / 5.0-7.0 m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	~6.00 m’ /5.0-3.0 m’, anësore majtas ~6.00 m’ / 5.0-3.0 m’, anësore / ~6.00 m’ / 5.0-3.0 m’, e pasme /
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=30%
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=50%
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=0.8
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60 %
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	15
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Fasadë termike dhe ventiluese
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:

